


## Klientë ekzitues të aplikacioni Mastercard Travel Experience MTE


### Para migrimit – 14 Maj deri 22 Qershor 2026

Përdoruesit e MTE përpiqen të hyjnë në MTP para datës 23 qershor do të shfaqen pamjet si më poshtë në aplikacion:



#### 1. Faqja e hyrjes

Përdoruesi sheh njoftime për migrimin nga MTE dhe përpiqet të hyjë në MTP




#### 2. Dritarja "Jeni herët"

Përdoruesi sheh një dritare që e njofton se është shumë herët – ata duhet të vazhdojnë të përdorin MTE për të aksesuar përfitimet e udhëtimit.


## Pas migrimit – nga 23 Qershor 2026

Pas datës 23 Qershor, pamja që klientët do të kenë ne aplikacion do të jetë:




**1. Parandalimi i hyrjes në MTE**

Që nga 23 qershori 2026, hyrjet në MTE do të bllokohen dhe përdoruesve do t'u shfaqet një mesazh që i drejton drejt MTP-së kur përpiqen të hyjnë në MTE.




**2. Hyrja në MTP para përdorimit**

Përdoruesit duhet të shkarkojnë aplikacionin MTP ose të hyjnë në faqen e MTP-së dhe të identifikohen me kredencialet ekzistuese të MTE (email dhe



### 3. Verifikimi i migrimit në MTP

MTP verifikon kredencialet dhe përfitimet e përdoruesit, duke kërkuar përditësime të kartës vetëm nëse është e nevojshme.



### 4. Hyrja në MTP pas verifikimit


Përdoruesi shfaqet në faqen kryesore të MTP-së me të gjitha përfitimet dhe rezervimet e migruara të disponueshme.

**Klientët e rinj që do të regjistrohen në Mastercard Travel Pass (MTP)**

**Nga 12 Maj 2026, mbajtësit e rinj të kartave regjistrohen vetëm në MTP**

Gjatë regjistrimit do të shfaqet njoftim në MTE:

*Ju lutemi shkarkoni MTP për t'u regjistruar*



**1. Klik "Regjistrohu" në MTE**

Përdoruesi shkarkon dhe klik "Regjistrohu" në MTE nga data 12 maj.

**2. Përdoruesi fut të dhënat e kartës**

Përdoruesi fut të dhënat e kartës gjatë regjistrimit. Bëhet kontroll vlefshmërie të kartës.

**3. Pop-up e MTP-së**

Nëse përdoruesi është i vlefshëm për MTP, shfaqet një dritare e detyrueshme që e informon se anëtarësia e tyre është transferuar në MTP.

## **FAQs**

### **Migrimi nga MTE në MTP – Pyetje të Shpeshta për Mbajtësit e Kartave**

#### **Çfarë është Mastercard Travel Pass?**

Mastercard Travel Pass është një platformë për përfitime udhëtimi, e ofruar nga DragonPass, që ofron akses në korsi të Fast Track, oferta për restorante dhe transferime në aeroport.

#### **Pse u zëvendësua Mastercard Travel Experiences?**

Mastercard Travel Pass zëvendëson Mastercard Travel Experiences për të ofruar një përvojë më të thjeshtë dhe të unifikuar për të gjithë mbajtësit e kartave, me përditësime më të shpejta, funksione më të mira dhe performancë të përmirësuar të aplikacionit.

#### **Kush ofron Mastercard Travel Pass?**

Mastercard Travel Pass ofrohet nga DragonPass, partneri global i Mastercard për përfitimet e udhëtimit.

#### **Si mund të aksesoj Mastercard Travel Pass?**

Shkarkoni aplikacionin Mastercard Travel Pass nga App Store ose Google Play dhe regjistrohuni me kartën tuaj Mastercard Premium të lëshuar nga Raiffeisen Bank. Mund ta aksesoni edhe përmes faqes zyrtare të Mastercard Travel Pass.

#### **Çfarë ndodh me rezervimet dhe informacionin e pagesës që kam ruajtur?**

Kartela juaj e ruajtur për pagesa, përfitimet dhe rezervimet aktive do të transferohen në mënyrë të sigurt në Mastercard Travel Pass.

#### **A duhet të fus përsëri të dhënat e kartës ose të verifikoj identitetin?**

Jo – të dhënat tuaja ekzistuese (email dhe fjalëkalim), token-at e pagesës dhe përfitimet do të transferohen automatikisht.

### **Si mund të regjistrohen mbajtësit e rinj të kartave?**

Mbajtësit e rinj të kartave të vlefshme mund të regjistrohen direkt në aplikacionin Mastercard Travel Pass duke përdorur të dhënat e kartës së tyre Mastercard.

### **Cilat karta janë të vlefshme për Mastercard Travel Pass?**

Vlefshmëria varet nga lloji i kartës dhe emetuesi i saj. Ju lutemi kontrolloni faqen e përfitimeve të kartës suaj ose kontaktoni emetuesin për detaje.

### **A duhet të krijohet një llogari të re nëse kam përdorur më parë Mastercard Travel Experiences?**

Jo – përdoruesit ekzistues do të migrohen automatikisht dhe mund të hyni në Mastercard Travel Pass me të njëjtat email dhe fjalëkalim.

### **Çfarë mund të bëj në aplikacionin Mastercard Travel Pass?**

Mund të rezervoni akses në Fast Track, të përfitoni oferta për restorante dhe të organizoni transferime në aeroport, të gjitha në një vend.

### **A do të ndryshojnë përfitimet e mia?**

Jo – përfitimet tuaja ekzistuese do të mbeten të njëjta dhe do të jenë të dukshme në aplikacion pas migrimit.

### **A ka ndryshime në procesin e rezervimit midis MTE dhe MTP?**

Jo, procesi i rezervimit është pothuajse i njëjtë në të dy aplikacionet.

**A mund të përdor dy aplikacionet njëkohësisht?**

Jo, mund të përdorni vetëm një platformë në një kohë.

**Çfarë bëj nëse nuk mund të kaloj në Mastercard Travel Pass me kredencialet ekzistuese?**

Mund të rivendosni fjalëkalimin në ekranin e hyrjes në Mastercard Travel Pass.

**Çfarë bëj nëse harroj fjalëkalimin ose email-in për të hyrë në aplikacion?**

Mund të rivendosni fjalëkalimin ose të rikuperoni email-in përmes opsioneve në aplikacion.

**Nëse llogaria ime është pezulluar ose fshirë në Mastercard Travel Experiences, por kam kartë të vlefshme, a mund të regjistrohem në Mastercard Travel Pass?**

Po, duhet të krijoni një llogari të re në Mastercard Travel Pass.